



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike
dhe të Drejtat e Njeriut***

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 01.12.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1.Projektligji “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes Istisn’a dhe marrëveshjes së Agjensisë Istisn’a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për projektin e rrugës Tiranë-Elbasan”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Mark Frroku, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Spartak Braho, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Nard Ndoka dhe Tahir Muhedini.

Mungojnë:

Edi Paloka, Oerd Bylykbashi, Blendi Klosi, Gent Strazimiri, Armando Prenga, Fatmir Mediu, Eduard Halimi, Kastriot Islami, Keltis Kruja, Mhill Fufi, Gjovalin Bzheta, Pirro Lutaj, Arben Ristani dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Milbana Treska – drejtore e Drejtorisë së Borxhit Publik në Ministrinë e Financave

Argita Totozani – përfaqësuese e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës

Majlinda Gjonaj – drejtore e Njesisë së Menaxhimit të Projektit Tiranë-Elbasan

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Duhet t'ju bëj me dije se kalendari i miratuar ditën e enjte në mbledhjen e Komisionit gjatë seancës, do të ketë disa ndryshime, për shkak të impenjimeve të kolegëve, por ndryshimet e datave dhe të orëve do t'ju dërgohen me e-mail.

Kjo është për njoftim.

Të gjithë e keni kalendarin, por do t'ju jepet edhe version i ri me ndryshimet. Sot do të shqyrtojmë projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes Istisn’a dhe marrëveshjes së Agjensisë Istisn’a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për projektin e rrugës Tiranë-Elbasan”.

Të ftuar nga Ministria e Financave kemi si përherë drejtoreshën e Drejtorisë së Borxhit Publik, zonjën Milbana Treska dhe nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, zonjat Totozani dhe Gjonaj.

(Diskutime pa mikrofon)

Fillojmë mbledhjen. Kush do ta prezantojë projektin?

Zonja Majlinda, urdhëroni!

Majlinda Gjonaj – Unë jam zonja Majlinda Gjonaj, drejtore e Njesisë së Menaxhimit të Projektit Tiranë-Elbasan. Në letrën amenduese të marrëveshjes bëhet fjalë për amendimin e njërës prej anekseve të marrëveshjes, që ka të bëjë me planin financiar të miratuar, sepse ka pasur ndryshime në komponentët financiarë të këtij aneksi, pasi ka pasur një shtim të donatorit, i cili ka qenë OPEC-u, pra bashkë me IBD-në dhe Abu Dhabi-n, ka hyrë në bashkëfinancim edhe OPEC-u. E dyta, është ndryshimi i komponentëve financiarë pas tenderimit të objekteve.

Ky projekt është i kompozuar në tri kontrata: janë dy segmente rrugore dhe tuneli. Pas tenderimit vlerat e projektit kanë rezultuar të ndryshme nga ato që ishin parashikuar në fazën e përgatitjes së marrëveshjes dhe, për këtë arsye është bërë letëramendimi me miratimin e Bankës Islamike. Ndërkohë është marrë miratimi nga Këshilli i Ministrave për këtë ndryshim të ankesit të marrëveshjes dhe sot jemi këtu për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja në lidhje me ato që ju jeni të interesuar.

Fatmir Xhafaj – Ne jemi për ta diskutuar dhe miratuar. Ministria e Financave ka ndonjë koment?

Relatori, zoti Peza?

(Diskutime pa mikrofon)

Dashamir Peza – Në bazë të kalendarit të punës jam caktuar nga komisioni si relator për projektligjin “Për ratifikimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes Istisn’a dhe marrëveshjes së Agjencisë Istisn’a ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për projektin e rrugës Tiranë-Elbasan”.

Sipas relacionit shoqërues të projektligjit, qëllimi i projektit të ndërtimit të rrugës Tiranë-Elbasan është të ndihmojë në mënyrë efikase rritjen dhe zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në rajonet e Shqipërisë Qendrore, Jugore dhe Juglindore dhe më gjerë dhe të përmirësojë e të lehtësojë lëvizjen e trafikut, veçanërisht të trafikut të makinave të rënda në segmentin rrugor Tiranë-Durrës për të cilin ne jemi të gjithë në dijeni. Ashtu siç u shpjegua edhe këtu, janë disa ndryshime që kanë të bëjmë me pjesëmarrjen e donatorëve dhe me mënyrën e përdorimit të fondeve.

Unë mendoj se ky projekt është shumë i rëndësishëm dhe pa diskutim duhet mbështetur. Nga kolegët kam mësuar se ka disa pyetje dhe unë do t’i mirëprisja pyetjet e kolegëve dhe sqarimet që do të bëhen këtu në komision.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Peza.

Pyetje nga kolegët? Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Unë kam një pyetje pasi ky është një ratifikim marrëveshje dhe në këtë kuadër ne kemi bërë disa korrigjime në rastin konkret. Mua më intereson cilësia e punimeve dhe jo korrigjimet që bëhen. Unë nuk mund të them tani pse janë bërë llogaritjet gabim, kur ato janë bërë që në fillim. Por ajo që më bie në sy, zoti kryetar, është se komponentët për punimet civile ulen në vlerën e 101 milionë dollarëve dhe janë të cilësuar si seksioni, 1, 2 dhe 3, ku punimet civile janë planifikuar më shumë dhe ulen në rastin konkret. Ajo që më shqetëson është që rritet konsulenca e shërbimeve me 400 mijë dollarë. Pra ulim 101 milionë dollarë punime dhe investime civile dhe rrisim dhe votojmë 408 mijë dollarë konsulencën e shërbimeve.

Pyetja ime është: në përlllogaritjet që janë bërë në fillim, kur është bërë projekti, nuk janë marrë në konsideratë këto gjëra dhe si na rezulton që paskemi më shumë para dhe fonde për punimet civile dhe na teprojnë dhe nuk paskemi planifikuar fonde për konsulencë shërbimesh?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Gjonaj.

Majlinda Gjonaj – Në lidhje me uljen e vlerës financiare të këtij projekti, siç e theksova dhe në fillim, projekti vetë është i përbërë nga tri kontrata, në të cilat janë dy segmentet rrugore para dhe mbas tunelit dhe tuneli ku të dy tubat e kalimit janë prej 5 kilometrash. Tuneli vetë ka qenë i parashikuar me fondet e buxhetit të shtetit, është prokuruar sipas ligjit të prokurimeve publike shqiptare dhe fondi limit, ka qenë parashikuar rreth 150 milionë dollarë. Firma fituese është përzgjedhur me 85 milionë dollarë. Këtu nuk bëhet fjalë për ulje të cilësisë dhe reduktim të vlerës financiare për arsye të cenimit të elementeve të standardit të projektit, por me përzgjedhjen e firmës, e cila ka dhënë realisht një vlerë pothuajse 60% të vlerës limit. Ndoshta unë mund të them që nuk është bërë përlllogaritja mirë e fondit limit, sepse neve na ka rezultuar si i vetmi segment ose një nga segmentet totalisht të përfunduar dhe realisht punimet janë kryer me shumë cilësi, operimi dhe mirëmbajtja janë në nivelet e standardit europian dhe nuk mund të them që ky përfitim në kosto ka sjellë shkelje të standardit të këtij projekti.

Ndërkohë, gabimi është bërë në parashikimin e fondit limit para tenderimit. Mbas tenderimit këto korrigjime që ne sjellim këtu, kanë të bëjnë me vlerat reale pas tenderimit. Nuk ka cenim të standardeve. Projekti i kësaj rruge është sipas standardeve europiane, gjë që e tregon qoftë tuneli, qoftë segmenti i tretë që ka përfunduar në 95% të tij. Segmenti i parë është akoma në ndërtim.

Për sa u takon shpenzimeve të konsulencës, duhet të kemi parasysh që konsulentë do të thotë shpenzime për supervizimin e punimeve, realisht shtesa ka ardhur si rrjedhojë se për të dy segmentet rrugore kemi shtim të afatit për përfundimin e tyre, ku tashmë segmenti i tretë, që është mbas tunelit, ka përfunduar, por segmenti i parë është akoma në ndërtim dhe shërbimet e konsulencës janë rritur vetëm për këtë arsye, pra për arsye të shtesës së kontratës së ndërtimit, ku automatikisht shtohet edhe kontrata e supervizionit.

Fatmir Xhafaj – Ka ndonjë pyetje?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kam një pyetje në funksion të përgjigjes që mora dhe nuk u kënaqa. Në qoftë se ju kuptova mirë zonjë, mua nuk më vjen mirë si qytetar që vlera ishte 150 milionë dollarë, siç thatë ju dhe në tender del një firmë dhe e fiton me 85 milionë. Këtu nuk është puna për të kursyer, por për të bërë një punë dhe vepër me cilësi, megjithatë kjo çështje është tejkaluar. Në momentin që është kursyer, zoti kryetar, nga 150 milionë në 85 milionë për punën e tunelit, na rezulton që supervizioni i punimeve në tunel do të marrë...

Kështu e ke 407.485 dollarë, kryesisht për arsye të shërbimit të konsulencës të seksionit të dytë të projektit (supervizimi i punimeve në tunel), unë lexoj shqip, në qoftë se e kam gabim më thuaj, pra supervizioni i tunelit, pavarësisht se vlera është fituar nga një firmë me 60% siç tha drejtoresha, do të marrë 400 e ca të tjera për konsulentë, ndërkohë që nuk është planifikuar fare dhe kjo mua më shqetëson.

Ne nuk mund të japim fonde e para për konsulencën më shumë, ndërkohë që për punimet civile i ulim dhe që të jem brenda procedurës, mbase duhet pyetur me seriozitet Komisioni i Ekonomisë në rastin konkret dhe të merret një mendim i saktë, përpara se ne të votojmë për këtë çështje.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zonja Gjonaj.

Majlinda Gjonaj – Në lidhje me vlerat e parashikuara dhe të tenderuara, më vjen keq zoti Fino, por unë nuk mund të jap shpjegim, sepse unë kam një vit që e kam marrë detyrën dhe këto janë vlera që unë i kam gjetur. Dua të them vetëm një gjë, që tuneli realisht është i standardeve të mira dhe punimet janë me cilësi shumë të mirë. Ndoshta për këtë duhet të japin llogari ata që e kanë bërë këtë paçavure, se realisht është një paçavure, por po mundohemi ta vëmë në vijë të paktën dhe në fund t'u japim shqiptarëve një projekt me vlera dhe ashtu siç duhet.

Në lidhje me shërbimin e konsulencës po e shpjegoj, sepse unë fola për konsulencën në total edhe të tunelit, specifike për tunelin është se aty ka ndodhur një fenomen. Në momentin që është tenderuar, kur është bërë edhe projekti i dy segmenteve rrugore, i cili është bërë mbas tunelit, ka dalë e nevojshme që tuneli të ulet 25 metra në nivelet dhe për uljen e niveletës dhe riprojektimin edhe një herë në niveletën e duhur, është dashur që konsulenti, që kishte fituar tenderin për supervizionin e këtyre punimeve, të bënte edhe rishikimin e dizajnit, pra kjo është vlera e konsulencës që kërkohet për shtesë të konsulentit.

Unë projektin e kam gjetur të mbyllur, me periudhë defektesh, pagesat ishin bërë. Realisht kanë rënë dakord me Bankën Islamike, është marrë në *objection* nga Banka Islamike për këtë shpenzim, qoftë edhe për rishikimin e dizajnit dhe ky është shpenzimi i tunelit që figuron aty, i konsulencës për tunelin që ju keni përpara.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Për shumicën e pyetjes e mora përgjigjen, por për ta saktësuar. Kjo është një pagesë për një punë tashmë të bërë, por shkon që, pasi të mbyllet i gjithë projekti, të bëhet një pagesë, kur dihet që nevojat për të bërë uljen që thatë ju 25 metra, ka qenë që në fillim të zbatimit të projektit?

Majlinda Gjonaj – Marrëveshjet financiare bëhen për vlerën totale të kredisë që merret dhe kjo marrëveshje është e shoqëruar dhe me dy anekse. Përderisa ka disa bashkëfinancuesë, normalisht një aneks ka të bëjë me kufijtë fizikë që përcakton saktësisht segmentet që financon secili nga donatorët dhe njëri nga anekset e tjerë ka të bëjë me treguesit financiarë, meqenëse ishin tri kontrata, ka të bëjë me punimet civile për të tria kontratat, punimet e konsulencës për të tria kontratat, por ka dhe një kontigjensi. Kjo është e parashikuar në një vlerë dhe jepet në përqindje mbi vlerën e kontratave ose mbi vlerën totale të parashikuar për punimet civile.

Në këtë marrëveshje nuk ka ndryshim të shumës totale, pra këto para që janë dhënë janë marrë nga kontigjencia e projektit, pra është brenda paketës financiare të miratuar në marrëveshje, por ka thjesht abdetim të elementeve financiare të saj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka diskutime.

Kush është dakord? Dakord.

Dashamir Peza – Një sekondë, sepse ngelën disa gjëra për diskutime. Është bërë një propozim, zoti Xhafaj, që, para se ta votojmë, të ketë një komunikim me Komisionin e Ekonomisë për të pasur më të qartë rrugën që duhet ndjekur për votimin e kësaj çështjeje, sepse ajo që më shqetëson edhe si relator, ka të bëjë me diçka shumë të rëndësishme. E para, këtu nga shpjegimet që u dhanë u tha që ky rialokim fondesh është përdorur për projektin, kurse në relacionin shpjegues thuhet për supervizionin e projektit. Pra të arrijmë të kuptojmë nëse këto janë shpenzuar për projekt të ri, apo për supervizion?

Fatmir Xhafaj – Keni ndonjë pyetje për zonjën apo përfaqësuesit e qeverisë?

Dashamir Peza – Pyetjet i bënë kolegët.

Fatmir Xhafaj - Ju vetë nuk keni pyetje?

Në qoftë se ka pyetje mund t'i drejtoheni zonjës. Ne nuk i drejtohem komisioneve të veçanta, ne i drejtohem vetëm seancës, e para. Ne nuk jemi komision përgjegjës, por jemi për dhënie mendimi dhe japim thjesht mendimin tonë në këndvështrimin e përputhshmërisë me Kushtetutën dhe me ligjet. Kjo marrëveshje, a është në përputhje me Kushtetutën, apo jo?

Kush është dakord në parim? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Neni 1. Dakord.

Neni 2. Dakord.

Në tërësi. Kush është dakord? Dakord.

Faleminderit edhe përfaqësuesve të qeverisë! Ju keni një vit, por mbas një viti të mos vini edhe ju e të na thoni: na falni se nuk i pamë mirë disa gjëra.

Ditë të mbarë!

E mbyllim këtu mbledhjen për sot.

Falënderojmë edhe medien.

MBLEDHJA MBYLLET